

AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQERISË TREGTARE  
"GEGA CONSULTING 2019"

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 990I, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", vendos hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 31.01.2019, ortaku:

**Afërdita GEGA**, atesia Rapo, e datelindjes 11.09.1960, e lindur ne Perëndi, Berat dhe banuese ne Elbasan, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtese e leternjoftimit me nr. 027571101 e nr. personal G0591105ID leshuar ne date 11.09.2009, me vullnetin e saj te lire dhe te plote, te shprehur mepermjet ketij akti themelimi, vendosi per krijimin e shoqerise tregtare "GEGA CONSULTING 2019",

me kushtet e meposhtme:

KREU I  
Neni I  
EMERTIMI

Shoqeria Tregtare do te ketë Emërtimin "GEGA CONSULTING 2019".


Neni 2  
FORMA JURIDIKE

Shoqëria Tregtare "GEGA CONSULTING 2019" themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. . Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.990I, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ku ne nenin 3 percaktohet se:

*" 1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkëta, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).*

*2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.*

*Afërdita Gega*



3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”

Neni 3  
KOHEZGJATJA

Shoqëria " GEGA CONSULTING 2019" sh.p.k do te vazhdoje veprimtarine e saj me një afat kohor te pakufizuar. Shoqëria mund të vendose prishjen e saj me Vendim Unanim te Asamblese se Përgjithshme te zakonshme dhe të jashtëzakonshme të ortakëve-Ortakut të vetëm.

Neni 4  
SELIA

Shoqëria Tregtare "GEGA CONSULTING 2019" sh.p.k e ka selinë ne adresën: Elbasan , Z.K. 8522, Lagjja "Shënkoll", Pasuria nr. I6/474 . Në varësi të Aktiviteti Tregtar Shoqëria mund te hapë degë apo filjale të saja në qytete të ndryshme të Shqipërisë ose jashtë vendit sipas legjislacionit përkatës. Ndryshimi i selisë së Shoqërisë bëhet nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve-Ortaku i vetëm.

Neni 5  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj:

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Dhënie me qira pasuri te paluajtshme.
- Konsulencë financiare.
- Ndërtime banesash dhe objekte te ndryshme.
- Projektme arkitektonike.

KREU II  
KAPITALI  
Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) lekë. Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise Afërdita GEGA, dhe perbehet nga I (nje) pjese/kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (njqind mije) lekë, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Aferdita Gega



Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### Neni 7 TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat e kapitalit janë lirish të Transferueshme ndërmjet Ortakeve. Ortaku që kërkon të shesë kuotën e tij një personi të tretë, duhet detyrimisht të njoftojë ortakëve të shoqerise blerjen e kuotave të tij në të njëjtat kushte si personit të tretë të cilit ai dëshiron t'ia shesë. Kur disa ortakë ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes dhe shprehin dëshirën e tyre për të blerë kuotën, ortakë shites gezon të drejtën diskrecionale për të zgjedhur se cilit ortak ai dëshiron të shesë totalisht ose pjesërisht kuotat e tij. Ortakët duhet të përgjigjen brenda 30 ditëve nëse dëshirojnë të blejnë kuotat e ofruara apo jo.

#### Neni 8 SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortakët-Ortaku vetëm financojnë, përfitojnë rimbursim të financimit të tyre dhe ndajnë fitimin e tyre në bazë të kuotave në kapitalin themeltar.

#### Neni 9 ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

- Administratori,
- Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme e Ortakeve-Ortaku i vetëm.
- Mandati është i vlefshëm për një afat 5 vjeçar. Mandatin e ushtron Administratori **Afërdita GEGA**.

#### Neni 10 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ushtron kompetenca në emër të Shoqerise.

1. Administratori disponon pasuri të shoqerise në favor të realizimit të të ardhurave për Shoqerine.
2. Administratori i shoqerise ka kompetencat për drejtimin e shoqerise me qëllim që shoqeria të realizojë Objektin e saj.

*Afërdita Gega*

3. Administratori nuk ka ato kompetenca qe statuti dhe ligji ua njej shprehimisht Asamblese se Ortakeve-Ortakut te vetem. Administratori perfaqeson Shoqerine ne marredhenie me te tretet si dhe perpara Organeve Administrative dhe Gjyqesore.
4. Administratori ka Kompetence te miratoje Llogarite Vjetore dhe paraqitjen e tyre nese eshte rasti per miratim perfundimtar nga Asambleja e Ortakeve.
5. Redaktimin e rregulloreve te brendshme te shoqerise.
6. Krijimin e strukturave te reja brenda shoqerise apo c'do Organi tjetër te nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise.
7. Perzgjedhjen e ekspertit kontabel dhe te komisionit te likuidimit.
8. Organizimi i mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve-Ortakut te vetem mund te behet edhe nga administratori.
9. Leshon certifikata aftesie sipas nenit 77 te ligjit nr.990I, date 14.04.2008.
10. Administratori nese do te tejkaloje percaktimet e Statutit dhe ligjit angazhon pergjegjesine e tij penale per shperdorim detyre.

#### Neni I1

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqerise ndahet ne periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### Neni I2

Shoqeria mban dokumentacionin e nevojshem financiar per administrimin e pasurise dhe per zhvillimin e te gjithe veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e te gjithe legjislacionit perkates ne fuqi.

Bilanci financiar i shoqerise perpilohet ne baze te raportit me shkrim te eksperteve kontabel te autorizuar dhe te raportit te paraqitur nga administratori brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Te dy raportet paraqiten dhe miratohen ne asamblene e ortakeve-ortakut te vetem brenda dates 30 qershor.

Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem, shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete, si dhe fondet financiare qe perbejne rezerven e detyrueshme.


#### Neni I3

### ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se shoqerise zgjidhen nga vete ortakët e shoqerise me mirekuptim nese jane me shume se nje ortak, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata ne territorin e se ciles ndodhet selia e shoqerise.

*Ajroli te Cepa Jua*





Neni I4  
EMERIMI I PERSONIT TE AUTORIZUAR TE NDJEKE PROCEDURAT

Për ndjekjen e Procedurave te nevojshme për regjistrimin e Shoqerise Tregtare në institucionet perkatese ngarkohet administratori.

Neni I5

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në Gjuhën Shqipe.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

Aferdita Gega

Aferdita GEGA

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE DURRES  
ZYRA NOTERIALE ELBASAN  
NOTERE ENTELA M.ÇAKO  
NR. 60 REP.  
NR. 34 /1 KOL.

Elbasan dt. 31.01.2019

**V È R T E T I M**

(Bazuar ne nenin 55 te Ligjit nr.7829 date 01.06.1994 "Per Noterinë")

Sot me date 31.01.2019 (tridhjetë e një Janar dymijë e nëntëmbëdhjetë), para meje notere Entela M. Çako, ne zyren time noteriale, me seli ne Lagjen "5 Maj", Rr. "Lef Nosi", Pall. 700/10, kati I, Elbasan u paraqit personalisht shtetasja shqiptare:

**Afërdita Gega**, atesia Rapo, e datelindjes 11.09.1960, lindur ne Perëndi, Berat dhe banuese ne Lagjen "Shenkoll", Elbasan, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga une Noterja nepermjet leternjoftimit ID me nr. 027571101 e nr.personal G05911051D, leshuar me date 11.09.2009, e cila deklaroi se dokumentin bashkengjitur –Akt Themelimi te Shoqerise "**GEGA CONSULTING 2019**" sh.p.k., e nenshkroi me vullnetin e saj te lire para meje noteres.

Une Noterja bazuar ne nenin 55 te Ligjit Nr. 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine"( i ndryshuar) e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERE**  
**ENTELA M. ÇAKO**

*Entela Çako*

*Egj*

